

V E N D I M
Nr.77, datë 31.12.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Hilmi Dakli,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Bardha Selenica,	Anëtare e “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 17.12.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.82 Akti që i përket:

KERKUES : PRESIDENTI I REPUBLIKES, i përfaqësuar nga këshilltari jurididik Theodhori Sollaku.

O B J E K T I:

Interpretimi i nenit 178, pika 1 e Kushtetutes ne lidhje me zbatimin e ligjit nr. 7528, date 11.12.1991 “Per funksionet e Keshillit te Mbrojtjes dhe te Komandantit te Pergjithshem te Forcave te Armatosura”.

Në kërkesë si shkak parashtrohet se:

Në bazë të nenit 178, pika 1 e Kushtetutës, ligjet që kanë dalë para miratimit të saj do të zbatohen derisa ato nuk janë shfuqizuar. Në këto kushte, si do të interpretohet kjo dispozitë në lidhje me Këshillin e Mbrojtjes, funksionet e të cilit mbi bazën e “Dispozitave Kryesore Kushtetuese” janë të përcaktuara nga Ligji nr.7528, datë 11.12.1991, ndërsa në Kushtetutë nuk parashikohet si organ.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi përfaqesuesin e palës kërkuese dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

V E R E N:

Në nenin 178, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me qëllim që të mos krijohet boshllëk i ndjeshëm legjislativ për marrëdhëniet e rregulluara nga ligjet e aktet normative të dala në bazë e për zbatim të Ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, (me ndryshimet e plotësimet përkatëse) është parashikuar shprehimisht se “Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar”. Nga shqyrtimi i kësaj dispozite, e lidhur kjo edhe me dispozita të tjera të Kushtetutës, e veçanërisht me ato të pjesës së 18 (dispozita kalimtare dhe të fundit), Gjykata Kushtetuese arrin në përfundim se rregulli i vendosur në atë nen do të zbatohet për ato organe kushtetuese që do të ekzistojnë pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Rregulli i mësipërm gjithashtu do të zbatohet edhe për ato ligje apo akte normative që në tërësi apo në pjesë të veçanta të tyre nuk vijnë në kundërshtim me dispozita konkrete të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, duke u nisur nga ky kuptim i nenit 178, pika 1 arrin në përfundim se përderisa Këshilli i Mbrojtjes, i parashikuar si organ kushtetues nga “Dispozitat Kryesore Kushtetuese” nuk ekziston më si i tillë , atëhere edhe Ligji nr.7528, datë 11.12 1991 në dispozitat që përcakton funksionet e tij nuk është i zbatueshëm.

Në këtë mënyrë, në Kushtetutë, ndryshe nga Dispozitat Kryesore Kushtetuese pranohet drejtimi unik i forcave të armatosura, duke u suprimuar Këshilli i Mbrojtjes si organ kolegjal e vendimor që kishte për funksion drejtimin, organizimin dhe mobilizimin e forcave dhe mjeteve për mbrojtjen e vendit.

Presidenti i Republikës, si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, deri në

miratimin e ligjeve që kërkon nenin 169, pika 4 e Kushtetutës ushtron të gjitha funksionet e kompetencat që kanë të bëjnë me forcat e armatosura dhe që parashikohen nga nenet 92, 168 dhe 169 të Kushtetutës, neni 8 i Ligjit nr.7528, datë 11.12.1991 si dhe në ligje të tjera.

PER KETO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 124 të Kushtetutës, njëzëri,

V E N D O S I:

Rregulli i parashikuar në nenin 178, pika 1 e Kushtetutës nuk zbatohet për dispozita ligjore që rregullonin funksionet e Këshillit të Mbrojtjes, si një organ që me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, nuk ekziston.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi nga dita që ka hyrë Kushtetuta në fuqi.

MENDIM PARALEL

Duke qenë se në arsyetimin e vendimit përmendet shprehimisht se Presidenti i Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, si organ kushtetues unik e jo më kolegjal, ka të drejtë të ushtojë të gjitha kompetencat në përshtatje edhe me ato që parashikon neni 169 pika 1, 2 e 3, deri në daljen me ligj të kompetencave të tij si parashikohet në pikën 4 të nenit 169 të Kushtetutës.

Jam për këtë shtesë edhe në pjesën e fundit të vendimit për qartësi e për mos interpretim tjetër të gabuar. Kjo edhe për faktin sepse edhe qëllimi i kërkesës del të jetë se cilat do të jenë kompetencat e tij me hyrjen në fuqi të Kushtetutës.

Tiranë, më 31.12.1998

A N E T A R
I H. Dakli

Nr. 82 i regjistrimit themeltar
Nr. 77 i vendimit.